

U D H Ë Z I M
Nr. 23, Date 17.04.2001

PËR MËNYRËN E VERIFIKIMIT NGA KZQV-TË TË REKORDEVE TË DUBLUARA NË LISTEN A TË ZGJEDHËSVE

Në mbështetje të nenit 41 pika 1 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

U D H Ë Z O N:

KZQV-të do të bëjnë verifikimin e rekordeve (zgjedhësve) të dubluar të listës A të zgjedhësve. Rekordet e dubluara janë printuar për çdo KZQV në dy lista :

Listën nr. 4

Listën nr. 5

Lista nr.4 përmban rekordet e dubluara brenda listës së çdo KZQV-je,kurse Lista nr.5 përmban rekorde, dublimet e të cilave ndodhen në listat e KZQV-ve të tjera.

Për verifikimin e dublimeve të Listës nr.4 do të veprohet në këtë mënyrë:

KZQV-ja do të çojë në Zyrën e Gjendjes Civile grupin tresh të verifikimit, i cili nëpërmjet emrit të regjistrit dhe numrit të faqes së tij ose nëpërmjet regjistrit me indeks do të përcaktojë adresat e rekordeve të dubluara dhe më pas do të bëjë verifikimin derë më derë të këtyre rekordeve.

Pas verifikimit ata duhet të përcaktojnë se cili nga rekordet e dubluara është zgjedhës i vërtetë dhe cili dublim. Në kolonën e statusit ata shenojnë germën “V” për rekordin që është zgjedhës dhe germën “Për rekordin që është dublim i tij. Në rastet kur dy rekordet e verifikuara nuk janë i njëjti zgjedhës (pra nuk është dublim), atëherë ata në kolonën e statusit shënojnë germën “V” për secilin prej tyre. (Në rastin kur zgjedhësi ka pasur një mbiemër tjetër ai shkruhet në kolonën përkatëse). Në qoftë se të dy rekordet nuk janë banorë në adresat përkatëse, ata shënojnë germën “L” në kolonën e statusit.

KZQV-ja pasi merr Listën nr.4 të verifikuar nga grupi tresh, i hedh statuset e përcaktuara në këtë listë, në Listën nr.3.

Për verifikimin e dublimeve të Listës nr.5 do të veprohet në këtë mënyrë:

KZQV-ja do të çojë në Zyrën e Gjendjes Civile grupin tresh, të cilët, nëpërmjet emrit të regjistrit dhe numrit të faqeve se tij (ose nëpërmjet regjistrit me indeks) do të përcaktojnë adresat e rekordeve të dubluara dhe, më pas, do të bëjnë verifikimin derë më derë të këtyre rekordeve.

Kur zgjedhësi kontaktohet, ata shkruajnë germën “V” në kolonën e statusit (kur zgjedhësi ka pasur një mbiemër tjetër ai shkruhet në kolonën përkatëse) dhe kur ai është i larguar (nuk banon më në atë vendbanim) shkruajnë germën “L”. KZQV-ja, pasi merr Listën nr.5 të verifikuar nga grupi tresh, i hedh statuset e përcaktuar në këtë listë, në Listën nr.3.

SHËNIM: Listat nr.4 dhe nr.5 do të firmosen faqe për faqe nga të tre anëtarët e grupit tresh të verifikimit. Në rast se një anëtar i saj ka kundërshtime, ai i shënon këto kundërshtime pas fletës përkatëse dhe i firmos ato.